



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA KOMERCIALE
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Kom.Dh.Shk.II.nr. 988/2023

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar i kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike të paditësit Bayerische Motoren Werke AG (BMW – AG), me seli në Gjermani, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson N. P., avokat në Prishtinë, kundër të paditurit NT “Ardi” N. S. I. B.I., NUI: ..., me seli në rr. “...” nr.52, në Ferizaj, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Gentiana Behluli nga Shoqëria e Avokatëve “...”, me seli në Prishtinë, me objekt kontesti shkelje e markës tregtare, duke vendosur lidhur me ankesën e te paditurës të parashtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2254/2022, të datës 28.04.2023, me datë 12.12.2023, mori këtë;

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e të paditurës NT “Ardi” N. S. I. B.I., NUI: ..., me seli në Ferizaj, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2254/2022, të datës 28.04.2023 VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar është aprovuar në tërësi si e bazuar kërkesëpapia e paditësit Bayerische Motoren Werke AG (BMW – AG), dhe është vërtetuar se i padituri NT “Ardi” N. S. I. B.I, me importimin e 44 disqeve të aluminit, ka shkelur markën tregtare “BMW”, me numër të regjistrimit 22809, markën tregtare figurative me numër të regjistrimit 22810, markën tregtare figurative me numër të regjistrimit 22812, markën tregtare “MINI” me numër të regjistrimit 22815 dhe markën tregtare figurative me numër të regjistrimit 22814. Me pikën II të dispozitivit është urdhëruar shkatërrimi i produkteve të cekura në pikën I të dispozitivit, me shpenzimet e të paditurit, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Me pikën III të dispozitivit është obliguar i padituri NT “Ardi” N. S. I. B.I., që ta publikoj këtë aktgjykim në dy gazeta ditore, në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi. Ndërkaq me pikën III. të dispozitivit është detyruar i padituri që paditësit të ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumën prej 425 € (katërqind e njëzetë e pesë euro), në afat prej 7 ditësh prej plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor ka paraqitur ankesë e paditura, për shkak të shkeljeve të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa e të paditurës si e bazuar, të anulohet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës –

Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.2254/2022, i datës 28.04.2023 ashtu që çështja të priset dhe t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rishqyrtim dhe rvinedosje.

Paditësja në përgjigje në ankesë propozon që të refuzohet si e pabazuar ankesa e të paditurës dhe të vërtetohet i Gjykatës Komerciale të Kosovës – Dhomat e Shkallës së Parë, KE.nr.1476/2022, të datës 23.05.2023.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e atakuar dhe pretendimet ankimore e pas vlerësimit të tyre në bazë të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësi “Bayerische Motoren Werke AG (BMW – AG), përmes të autorizuarit të tij, me datën 12.02.2021, pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Ekonomike, ka paraqitur padi për shkeljen e markës tregtare kundër të paditurit NT “Ardi” N. S. I B.I, me të cilën ka kërkuar që aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, të vërtetohet se i padituri NT “Ardi” N. S. I B.I, ka shkelur markën tregtare të paditësit Bayerische Motoren Werke AG (BMW – AG) me importimin e 44 disqeve të aluminitit “BMW” dhe “MINI”, të obligohet i padituri që të i shkatërroj produktet, me shpenzimet e veta, të publikoj dispozitivin e këtij aktgjykimi në dy gazeta ditore, të i paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore e të gjitha këto në afat prej 7 ditëve nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së parë ka administruar provat e propozuara dhe ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar sepse produktet e të paditurit janë pothuajse identike me markën tregtare të paditësit. Nga vështrimi me kujdes në foto dokumentacionin i cili gjendet në shkresat e lëndës, vërehet se disqet e rrotave të automjeteve, përmbajnë shenja identike apo pothuajse identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret ngjashmëritë janë të nivelit që mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe mundësia e asocimit të produktit të paditurit me produktin e mbrojtur me markë tregtare të paditësit është e nivelit të theksuar. Gjykata e shkallës së parë pas vërtetimit të gjendjes faktike ka ardhur në përfundim se mundësia e shkakimit të konfuzionit është shumë e madhe për shkak se të dy produktet, edhe produkti i paditësit i mbrojtur me markë tregtare dhe ai i të paditurit janë të së njëjtës natyrë, qëllimi i përdorimit të dy produkteve është i njëjtë, janë në konkurrencë me njëra tjetrën. Kjo më tepër për faktin se produktet mund të shpërndahen nëpër pika të njëjta të shitjes, dhe se këta faktorë e shtojnë mundësinë e asocimit në mes të këtyre dy produkteve. Po ashtu kjo mund të reflektojë drejtpërdrejtë edhe në aspektin ekonomik tek të dy subjektet ekonomike.

Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale, si gjykatë e shkallës së dytë e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se, aktgjykimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 par 2. nën pikat b), g), j), k) dhe m) të LPK. Për shkak të zbatimit të rregullt të rregullave të procedurës kontestimore dhe për shkak të konstatimit të rregullt dhe të

tërësishëm të gjendjes faktike, drejtë është zbatuar edhe e drejta materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë. Këto shkaqe ankimore i heton dhe vlerëson gjykata e shkallës së dytë sipas detyrës zyrtare e në bazë të nenit 194 të LPK.

Kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë i vlerësoi të paqëndrueshme pretendimet ankimore lidhur me gjendjen faktike respektivisht lidhur me konstatimin se mallrat janë origjinale dhe nuk shkelin markat tregtare të paditësit. Sipas vlerësimit të kolegjit, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vepruar me rastin e vërtetimit të shkeljes së markës tregtare duke vërtetuar drejtë gjendjen faktike kur ka konstatuar se shenja që është përdorur në produktet e të paditurit është identike me markën tregtare të paditësit dhe se në rastin konkret shenjat e përdorura në mallrat e të paditurit nuk ka asnjë dyshim se mund të shkaktojnë konfuzion në publik dhe secili konsumator do të krijoj bindjen se bëhet fjalë për produktet e paditësit. Në këtë drejtim gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme me c’rast ka konstatuar se rezulton si jokontestues fakti se i padituri ka importuar mallrat kontestuese pa autorizimin e paditësit si bartës i të drejtave nga marka tregtare e regjistruar. Edhe kolegji i Dhomave të Shkallës së Dytë është i qëndrimit të njëjtë me gjykimin në shkallë të parë se fakti se mallrat janë origjinale ose jo nuk përbën fakt relevant për vlerësimin e shkeljes së markës tregtare.

Sipas Nenit 8 të Ligjit Nr. 04/L-026 Për Markat Tregtare (LMT) i aplikueshëm në rastin konkret, të drejtat nga markat tregtare konsiderohen të drejta pronësore dhe të njëjtat përbëjnë të drejta absolute. Kjo nënkupton se të gjitha palët e treta obligohen që të përmbahen nga përdorimi i paautorizuar i markës tregtare të regjistruar. Titullar i markës tregtare mund të ndalojë palët e treta që pa pëlqimin e tij të përdorin shenjë identike ose të ngjashme për mallrat apo shërbimet të llojit të njëjtë ose të ngjashme. Me regjistrimin e një marke të caktuar, bartësi i markës tregtare fiton të drejtën ekskluzive mbi markën tregtare.

Dhomat e Shkallës së Dytë të gjykatës Komerciale vlerësojnë se shkelja e markës tregtare mund të bëhet me çdo veprim të ndërmarrë pa autorizimin e pronarit, me të cilin atakohet të paktën njëri prej të drejtave të pronarit të markës tregtare të përcaktuar me Nenin 8 të LMT-së. Kjo shkelje mund të bëhet gjatë kohës së vlefshmërisë së markës tregtare, brenda territorit për të cilën ajo është e autorizuar. Sipas Nenit 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.2, i LMT-së, pronari i një marke të regjistruar nuk ka nevojë të vërtetojë konfuzionin që faktikisht është krijuar nga përdorimi i markës identike ose të ngjashme, por vetëm mundësinë e krijimit të një konfuzioni tek konsumatorët. Në rastin konkret kemi të bëjmë me marke tregtare të regjistruar e cila ia njeh pronarit ekskluzivitetin e përdorimit për tërë territorin e Kosovës ndërsa nga provat që gjenden në shkresat e lëndës rezulton si i bazuar pretendimi i paditëses për mundësinë e shkakimit të konfuzionit, për shkak se shkelje e markës tregtare.

Bazuar në dispozitat e sipërcituara vetëm fakti i importimit dhe vendosjes në treg të mallrave në tregun përkatës, pa autorizimin e bartësit të së drejtës së markës tregtare të regjistruar, përbën shkelje të mjaftueshme të markës tregtare.

Sipas vlerësimit të Kolegjit, nga shkresat e lëndës, e në veçanti nga foto-dokumentacioni i siguruar nga Dogana e Kosovës shihet qartë se produkti i paditëses dhe të paditurës kanë ngjashmëri ndërmjet tyre dhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit është e madhe pasi që shenja e përdorur në produktet e të paditurës asociojnë në shenjën e regjistruar si markë tregtare nga paditësja, mallrat janë të ngjashme respektivisht të së njëjtës kategori dhe ndërmarrjet janë në konkurrencë me njëra tjetrën. Prandaj kjo gjykatë vlerëson se përdorimi i shenjës së ngjashme të paditëses në produktin e të paditurës, në dizajn dhe forme pothuajse identike shkelin markën tregtare të paditësit, pa u lëshuar në vlerësimin e origjinalitetit të produktit ose jo.

Për më tepër produktet e paditësit që përmbajnë markën tregtare të tij, janë produkte të mirënjohura që kanë përdorim të gjerë dhe e përdor qytetari i rëndomtë, andaj edhe rrethi i konsumatorëve është i gjerë, nuk kanë kujdes të shtuar gjatë blerjes së këtij produkti dhe lehtësisht mund të mos e dallojnë diferencën ndërmjet mallrave të paditësit dhe mallrave kontestuese të së paditurës. Prandaj edhe mundësia e shkaktimit të konfuzionit tek këta konsumator është shumë e madhe sepse të njëjtit me vëmendje të rëndomtë nuk do ta dallonin produktin e paditëses nga produkti i të paditurës, për shkak se këto dy produkte kanë shenjë pothuajse identike.

Kolegji i kësaj gjykate i shqyrtoi pretendimet tjera ankimore sa i takon refuzimit të propozimit të palës së paditur për caktimin e ekspertizës për të vërtetuar origjinalitetin e mallrave, e po ashtu edhe për shtyrjen e seancës me qëllim të sigurimit të provave të tjera. Lidhur me këto pretendime Kolegji vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka shkelur dispozitat procedurale për arsye se faktet vendimtare për të ardhur deri te vlerësimi i shkeljes së markës tregtare janë vërtetuar mjaftueshëm. Siç u theksua, në rastin konkret ka qenë i parëndësishëm elementi i origjinalitetit të produktit, por ka mjaftuar vetëm konstatimi se paditësi është pronar dhe bartës i të drejtës së markës tregtare, e cila si e drejtë absolute i lejon pronarit të imponojë një numër kufizimesh ndaj palëve të treta, përfshirë këto çdo importim nga një palë e tretë e produkteve sipas dispozitave të Nenit 8 par.2.3 i LMT-së. Rrjedhimisht, ekspertiza për vërtetimin e origjinalitetit të produkteve ka qenë e panevojshme për të vërtetuar faktet në këtë kontest gjyqësor. Ndërkaq, refuzimi i shtyrjes së seancës po ashtu rezultoi pa shkelje procedurale, pasi që palët i kanë pasur në dispozicion të gjitha prerogativat ligjore që të përgatisin çështjen e tyre në gjykatë brenda kornizave dhe afateve procedurale. Po ashtu propozimi i provave ka qenë i mundshëm gjatë shqyrtimit përgatitor dhe shtyrja e shqyrtimit kryesor me pretekst të mbledhjes së provave të reja nuk e obligon gjykatën për t'i dhënë mundësi shtesë palëve, për lëshimet e tyre në përgatitjen e mbrojtjes së tyre në gjykatë.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, kjo gjykatë vlerëson se aktgjykimi i atakuar i gjykatës së shkallës së parë nuk ka të meta për shkak të së cilave nuk mund të vlerësohet ligjshmëria e tij, dispozitivi i aktgjykimit është i kuptueshëm, nuk është në kundërtënie me vetveten ose me arsyet e aktgjykimit dhe se aktgjykimi përmban arsye të mjaftuara dhe bindëse për gjendjen faktike dhe juridike, për të vendosur në këtë çështje juridike, të cilat në tërësi i aprovojnë edhe Dhomat e Shkallës së Dytë të Gjykatës Komerciale .

Nga sa u parashtrua e në mbështetje të dispozitës së nenit 200 të LPK është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e Shkallës së Dytë,
Kom.Dh.Shk.II.nr. 988/2023, me datë 12.12.2023

Kryetari i Kolegjit, gjyqtari
Dren Rogova